	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 1 nga 10</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

Bazuar në nenet 8, 10 (paragrafi 2.2.) dhe 15 të Ligjit të punës nr.03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenet 5 (paragrafi 1, 2, 4, 5) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-nr. 01/2024 dhe plotësim ndryshimit të UA 03/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nenet 5.3.2 dhe 7.1 të Manualit të punëtorëve si dhe nenet 6.2, 7.3 dhe 9.2 të Politikës së rekrutimit, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh. a. për plotësim të vendeve të lira të punës si më poshtë, shpall:

KONKURS PUBLIK

1. Inxhinier/e për Testim dhe Mirëmbajtje të Transformatorëve, Transformatorëve të fuqisë dhe Autotransformatorëve (1 kryes)
2. Inxhinier/e për Mirëmbajtje dhe Riparim të Qarqeve Primare (1 kryes)
3. Specialist/e për Çështje Pronësore Juridike (1 kryes)
4. Specialist/e për llogari të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe inventar (1 kryes)

Titulli i vendit të punës:	Inxhinier/e për Testim dhe Mirëmbajtje të Transformatorëve, Transformatorëve të fuqisë dhe Autotransformatorëve
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.
Numri referues:	1.6.3.6
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	1026.00 euro
Numri i kryesve:	1
Kushtet e punës:	Punë në Zyre dhe Teren
Vendi i punës (lokacioni):	Selia Qendrore KOSTT
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)


Përmbledhje e detyrave për pozitën: Inxhinier/e për Testim dhe Mirëmbajtje të Transformatorëve, Transformatorëve të fuqisë dhe Autotransformatorëve:

Detyrat e përgjithshme

Inxhinieri/ja për Testim dhe Mirëmbajtje të Transformatorëve, Transformatorëve të fuqisë dhe Autotransformatorëve mbështet Menaxherin e Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Nënstacioneve- QP, në kryerjen e aktiviteteve operative në lidhje me testimin dhe mirëmbajtjen e Transformatorëve me qëllim të funksionimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas të transformatorëve matës, transformatorëve të shpenzimeve vetanake të nënstacioneve, transformatorëve të fuqisë dhe autotransformatorëve në rrjetin e transmetimit të KOSTT, përmes testeve, monitorimit dhe mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, në përputhje me standardet relevante.

Ai/Ajo i raporton sipas hierarkisë:

- Menaxherit të Sektorit për Mirëmbajtje dhe riparim të Qarqeve Primare,
- Drejtorit të Departamentit për Operim të Transmisionit

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 2 nga 10</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

Detyrat specifike:

Inxhinier për Testim dhe Mirëmbajtje të Transformatorëve, Transformatorëve të fuqisë dhe Autotransformatorëve ndihmon Menaxherin e Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Nënstacioneve- QP në mirëmbajtjen dhe riparimin e Transformatorëve. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë:

Bënë testime dhe diagnostikim teknik të transformatorëve

- Kryen testime periodike dhe speciale për transformatorët matës të rrymës, transformatorët matës tensionit, transformatorëve të shpenzimeve vetanake të nënstacioneve, transformatorëve të fuqisë dhe autotransformatorëve në pronësi të KOSTT:
 - TTR – raporti i transformimit
 - Winding Resistance – rezistencat e përfshirjeve
 - Tan δ / Power Factor
 - Insulation Resistance (IR/PI)
 - FRA – analiza e përgjigjes së frekuencave
 - Testet e qarkut të shkurtër dhe të boshllëkut
 - Testime me pajisje të tensionit të lartë
- Përdor pajisje diagnostikuese të avancuara OMICRON, Megger etj.

Bënë analizat e vajit izolues


- Merr mostra vaji për analiza laboratorike (DGA, dielektriciteti, përmbajtja e lagështisë, acidi, tan δ).
- Vlerëson rezultatet sipas metodologjive dhe standardeve IEEE C57 dhe IEC 60599
- Identifikon prishje të mundshme të brendshme si: harkime, ngrohje lokale, defekte të bërthamës dhe kontaktet e rregullatorit të tensionit (On-load tap changer).

Bënë mirëmbajtjen parandaluese dhe korigjuese

- Zbaton programin vjetor të mirëmbajtjes së KOSTT, duke përfshirë:
 - Kontroll mekanik dhe elektrik të transformatorëve
 - Kontroll të lidhjeve HV/MV
 - Kontroll të transformatorëve matës (CT, VT)
 - Inspektime rutinë të gjendjes së radiatorëve, ftohjes, nivelit të vajit, izolatorëve, enëve të silikagellit
- Regjistron çdo anomali dhe propozon masa për përmirësim.
- Ndërhyn në mënyrë korigjuese për të adresuar defektet e raportuara nga SCADA ose nga operatorët e nënstacioneve.

Bënë monitorimin në kohë reale

- Analizon të dhënat e marra nga SCADA/EMS apo nga operatorët në nënstacione për:
 - Ngarkesën e transformatorëve
 - Temperaturat e mbërritjes / mbingarkesat
 - Alarmet operative
- Reagon me kohë për anomali teknike për të shmangur avaritë në rrjet.
- Harton raporte të vlerësimit të rrezikut teknik për transformatorët me probleme.

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 3 nga 10</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

Bënë menaxhimin teknik dhe dokumentimin

- Përgatit dokumentacion teknik sipas kërkesave të KOSTT:
 - Raporte testimi
 - Raporte mirëmbajtjeje
 - Formularë të kontrollit të nënstacioneve
 - Regjistrat teknikë të aseteve
- Përditëson bazën e të dhënave të KOSTT për historikun e transformatorëve

Bënë sigurimin e vendit të punës duke shfrytëzuar procedurat operative


- Zbaton me rigorozitet rregullat e punës dhe të sigurisë në punë në nënstacione të KOSTT (tokëzime, distanca të sigurisë).
- Siguron kalibrimin e rregullt të pajisjeve të testimit.
- Koordinon punimet me ekipet e Operimit për marrjen e lejeve, izolimin e fushave dhe organizimin e punimeve.

Mban bashkëpunim të ngushtë me sektorët tjerë të mirëmbajtjes

- Bashkëpunon ngushtë me:
 - Seksionin e Operimit të Nënstacioneve
 - Seksionin e Mbrojtjeve Rele
 - Sektorin e mirëmbajtjes së qarqeve sekondare
 - Sektorin e SCAD-ës
 - Ekipet e mirëmbajtjes
- Merr pjesë në testimet FAT/SAT për transformatorë të rinj ose të rehabilituar.

Detyra të tjera

- Merr pjesë në shqyrtimin e planeve, dizajneve dhe bënë aprovimin e tyre në kuadër të zhvillimit të projekteve.
- Merr pjesë në komisionim dhe përcjelljen e projekteve që zhvillohen në kuadër të zhvillimit të rrjetit elektroenergjetike të KOSTT, si dhe testimet e pajisjeve në kuadër të pranimit teknik apo në kuadër të lëshimit në punë
- Merr pjesë në planifikimin e materialeve dhe pjesëve rezerve për periudha të ndryshme.
- Merr pjesë në hartimin e procedurave dhe rregulloreve interne në KOSTT.
- Kryen detyra të tjera që mund të kërkohen nga Menaxheri i Sektorit dhe detyra të nevojshme për funksionimin efikas të KOSTT-it
- Merr pjesë në shqyrtimin e planeve, dizajneve dhe bënë aprovimin e tyre në kuadër të zhvillimit të projekteve.
- Merr pjesë në komisionim dhe përcjelljen e projekteve që zhvillohen në kuadër të zhvillimit të rrjetit elektroenergjetike të KOSTT, si dhe testimet e pajisjeve në kuadër të pranimit teknik apo në kuadër të lëshimit në punë
- Merr pjesë në planifikimin e materialeve dhe pjesëve rezerve për periudha të ndryshme.
- Merr pjesë në hartimin e procedurave dhe rregulloreve interne në KOSTT.

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 4 nga 10</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

- Kryen detyra të tjera që mund të kërkohen nga Menaxheri i Sektorit dhe detyra të nevojshme për funksionimin efikas të KOSTT-it.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollim: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike – profili energjetik (e detyrueshme).

Dega/drejtimi/lëmia: /

Përvoja e punës:

- Përvojë pune profesionale 2 vite
- Përvojë në OST/OSHE ose kompani të ngjashme të sektorit të energjisë (e preferueshme).
- Njohuri të thelluara për transformatorë fuqie, autotransformatorë dhe transformatorë matës.
- Aftësi në raportim teknik dhe punë në ekip.
- Njohja e gjuhës Angleze

Titulli i vendit të punës: Inxhinier/e për Mirëmbajtje dhe Riparim të Qarqeve Primare
Ndërmarrja: KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues: 1.6.3.1
Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj
Orari i punës: Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore: 1026.00 euro
Numri i kryesve: 1
Kushtet e punës: Punë në Zyre dhe Teren
Vendi i punës (lokacioni): Selia Qendrore KOSTT, Prishtinë
Mënyra e aplikimit: Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Inxhinier/e për Mirëmbajtje dhe Riparimit të Qarqeve Primare


Detyrat e përgjithshme:

Inxhinieri/ja i/e Mirëmbajtjes dhe Riparimit mbështet Menaxherin e Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Nënstacioneve në kryerjen e aktiviteteve operative në lidhje me mirëmbajtjen dhe riparimin e nënstacioneve.

Detyrat specifike:

Inxhinieri/ja i/e Mirëmbajtjes dhe Riparimit ndihmon Menaxherin e Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Nënstacioneve në mirëmbajtjen dhe riparimin e nënstacioneve. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë ndihma dhe mbështetja në kuptim të:

- Monitorimi i performancës së nënstacioneve.
- Shënimi i performancës dhe incidenteve të nënstacioneve.
- Mbikëqyrja dhe pjesëmarrja në mirëmbajtjen e nënstacioneve.
- Siguroj qasje të sigurtë në nënstacione për mirëmbajtje dhe punë të reja ndërtimore.

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 5 nga 10</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>


- Gjatë tërë kohës merr masa të menjëhershme përmirësuese në rast të devijimit të performancës së nënstacioneve.
- Organizon punën në inspektimin, mirëmbajtjen, riparimet dhe rikonstruktivet e pajisjeve të TL 110,220 dhe 400kV dhe pajisjeve të TM 6.3kV, 10 (20) kV, 35kV.
- Mirëmban planet javore, mujore, dhe vjetore të mirëmbajtjes.
- Në koordinim me dispeçerët kryesor hap dhe mbyll urdhëresat e punës.
- Në koordinim me menaxherin hap dhe mbyll detyrat e punës, autorizimet, etj.
- Kurdo që të jetë e nevojshme merr pjesë në intervenimet emergjente.
- Merr pjesë në ndërtimin dhe demontimin e pajisjeve të TL.
- Sipas nevojës ndihmon ekipin, dhe kryen punë sipas kërkesës së eprorit.
- Gjatë intervenimeve dhe riparimeve bënë përdorimin e drejtë të veglave dhe pajisjeve të punës, si dhe përkujdeset për procedurat e sigurisë në punë.
- Gjatë punës në objekte përkujdeset për sigurinë e punëtorëve.
- Jep propozime dhe sugjerime për përmirësimin e mirëmbajtjes dhe revizionin e planit të mirëmbajtjes dhe performancës.
- Deleton detyra dhe koordinon punën e punëtorëve, njofton Menaxherin e Mirëmbajtjes për pajisje dhe pjesë rezervë.
- Merr pjesë në testimin dhe shqyrtimin e pajisjeve të tensionit të lartë, krijimi i raporteve dhe rekomandimet për fazat e ardhshme.
- Merr pjesë në testimin dhe shqyrtimin e transformatorëve të fuqisë me pajisje të avancuara, krijimi i raporteve dhe rekomandimet për fazat e ardhshme.
- Merr pjesë në shqyrtimin e planeve, dizajneve dhe aprovimin e tyre në kuadër të zhvillimit të projekteve.
- Merr pjesë në komisionim dhe përcjelljen e projekteve që zhvillohen në kuadër të zhvillimit të rrjetës elektroenergjetike të Kostt, si dhe testimet e pajisjeve në kuadër të pranimit teknik apo në kuadër të lëshimit në punë.
- Merr pjesë në planifikimin e materialeve dhe pjesëve rezerve për periudha të ndryshme.
- Merr pjesë në hartimin e procedurave dhe rregulloreve interne në KOSTT.
- Bashkëpunon me sektoret tjerë në KOSTT sipas nevojës.
- Përgjegjës për implementimin e procedurave dhe rregullores së sigurisë në punë në raport me ekipet që kryejnë punë në NS.

Të tjera

Kryen detyra të tjera siç mund të kërkohen nga Menaxheri i Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Nënstacioneve dhe si të jetë e nevojshme për funksionimin efikas të KOSTT-it.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 6 nga 10</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

Dega/drejtimi/lëmia: /

Përvoja e punës:

- Përvojë pune profesionale 2 vite
- Përvojë në pajisjet e tensionit të lartë
- Njohuri të sektorit të shërbimeve publike në nivel lokal dhe global
- Njohja e gjuhës angleze

Titulli i vendit të punës: Specialist/e për çështje pronësore juridike
Ndërmarrja: KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues: 1.3.0.2
Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj
Orari i punës: Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore: 826.00 euro
Numri i kryesve: 1
Kushtet e punës: Puna në Zyre dhe Teren
Vendi i punës (lokacioni): Selia Qendrore KOSTT, Prishtinë
Mënyra e aplikimit: Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Specialist/e për çështje pronësore juridike

Detyrat e përgjithshme:


Detyra e Specialistit/es për Çështje Pronësoro Juridike është të mbështesë Menaxherin e Zyrës Ligjore lidhur me të gjitha detyrat operative ligjore.

Detyrat specifike:

Specialist/ja për Çështje Pronësore Juridike bashkëpunon me Menaxherin e Zyrës Ligjore për të gjitha obligimet që rrjedhin në aspektin ligjor si në draftimin e dokumenteve ligjore (kontrata, shkresa për gjykatë, përgatitje të aplikacioneve për leje për ndërtim, etj.), si dhe përfaqësime në seanca gjyqësore.

Detyrat e tij/saj specifike dhe përgjegjësitë janë:

- Përfaqësimi i KOSTT-in në seanca gjyqësore në të gjitha kontestet gjyqësore, sipas autorizimit nga Kryeshefi Ekzekutiv apo Menaxheri i Zyrës Ligjore
- Përgatitje dhe është përgjegjës për të gjitha parashtresat dhe paditë lidhur me lëndët në të cilat KOSTT është palë
- Siguron përfaqësimin e duhur dhe të afatshëm në të gjitha seancat
- Në koordinim me departamentet tjera të KOSTT përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kompensimin e palëve të treta për shpronësim, servitut dhe dëmeve tjera eventuale.
- Angazhimi në çështjet e pronës së kompanisë, sigurimi i dokumentacionit për pronësi, aplikimi për leje urbanistike, mjedisore dhe ndërtimore për projektet e reja në proces të implementimit dhe

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 7 nga 10</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

organizimi dhe mbajtja e debateve publike, përcjellja e dokumentacionit dhe aplikimi për tu pajisur me Leje sipas legjislacionit në fuqi për projektet e ndërmarrjes.

- Hartimi i parashtresave ligjore apo ndonjë dokument tjetër që kërkohet në lidhje me përfaqësimin ligjor dhe ofron informacione lidhur me çështjet ligjore.
- Asiston dhe e mbështetë Menaxherin e Zyrës Ligjore në përshtatshmërinë ligjore dhe raportimi lidhur me konfliktin e ligjeve në çështjet e ndryshme procedurale.
- Pjesëmarrja në Komisione të ndryshme
- Mban evidencën dhe regjistrin të gjitha shkresat në librat e këtij sektori; përcjell dhe është përgjegjës për respektimin e afateve ligjore në përmbushjen e detyrave, seancat gjyqësore sipas ftesave, etj.
- Përgatitja e Raporteve për konteste gjyqësore apo raporte tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri i Zyrës Ligjore
- Ruajtja, sistematizimi dhe mirëmbajtja e dokumenteve që i përkasin zyrës ligjore, përkatësisht lëndëve gjyqësore në formë të shtypur dhe elektronike
- Koordinimi me stafin për implementimin e projekteve lidhur me ndryshimet

Shqyrtimi i ndryshimeve ligjore

Mbështet Menaxherin e Zyrës Ligjore në monitorimin e ndryshimeve ligjore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, e posaçërisht.

- Monitoron dhe analizon ndryshimet ligjore me ndikim në çështjet e mjedisit dhe njofton menaxherin për implementim të projekteve.

Të tjera

Kryen punë tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri i Zyrës Ligjore që kërkohen për funksionim efektiv të KOSTT-it.


Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: Fakulteti Juridik

Dega/drejtimi/lëmia: /

Përvoja e punës:

- Përvojë pune profesionale 3 vite.
- Njohuri të thellë të çështjeve ligjore dhe rregullative.
- Njohuri të thellë të legjislacionit për të drejtat pronësore, çështjet mjedisore dhe ndërtimore.
- Njohuri bazë e industrisë publike në nivel lokal dhe global.
- Njohje e mirë e gjuhës angleze.
- Të posedoj Patent shofer/kategoria B.

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 8 nga 10</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

Titulli i vendit të punës:	Specialist/e për llogari të pagueshme dhe inventar
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.
Numri referues:	1.9.2.3
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	826 euro
Numri i kryesve:	1
Kushtet e punës:	Puna në zyre dhe Teren
Vendi i punës (lokacioni):	Selia Qendrore e KOSTT-it, Prishtinë
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Specialist/e për llogari të pagueshme dhe inventar

Detyrat e përgjithshme:

- Planifikimi, zbatimi dhe menaxhimi I procedurave për të optimizuar cilësinë e kontrollit
- Regjistrimi i transaksioneve kontabël për llogari të pagueshme
- Kontrollimi i saktësisë së regjistrave kontabël
- Kontrollimi/sigurimi I saktësisë së të dhënave në librin e blerjes
- Kontrollimi dhe barazimi i kartelave financiare me blerësit/furnitorët
- Të sigurohet që ka përpunim korrekt dhe në afat ligjor të pagesave
- Bën arkivimin dhe sistemimin e dokumenteve financiare
- Monitorimi periodik i pagesave dhe raportimi tek menaxheri
- Bashkëpunimi me specialistin e tatimeve për implementimin e të gjitha ndryshimeve të legjislacionit tatimor
- Evidentimi dhe barazimi me të dhënat kontabël të inventarit dhe
- Detyra dhe përgjegjësi tjera që i caktohen nga menaxheri

Të tjera


Kryen detyra tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri i Sektorit të Kontabilitetit, Drejtori i Departamentit të Financave dhe Thesarit, të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT-it.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: **Diplomë e Fakultetit Ekonomik, niveli pasuniversitar konsiderohet përparësi**

Dega/drejtimi/lëmia: **/**

- Certifikimet në fushën përkatëse e dëshirueshme
- Përvojë pune profesionale minimum 3 vite
- Njohje bazike e veprimtarisë së kompanisë
- Të jetë fleksibil dhe i gatshëm për tu adaptuar me nevojat dhe kërkesat e sektorit
- Aftësi për punë ekipore
- Aftësi analitike në punë

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 9 nga 10</i>
Departamenti i Burimeve Njerëzore		Sektori i Personelit

- Njohje e gjuhës angleze

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë
Intervista deri në njëzet (20) pikë
Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

Mënyra e aplikimit


Aplikimi bëhet vetëm në formë elektronike, përmes adresës elektronike. Dokumentet duhet të ngarkohen sipas kërkesave të konkursit. Pasi të dërgoni aplikimin tuaj përmes email adresës elektronike do të pranoni një email për konfirmim të pranimit të email-it tuaj. Nëse nuk keni pranuar email-in konfirmues, atëherë shkruani në email adresën punesimi@kostt.com (vetëm në rastin kur pas aplikimit nuk e keni pranuar email-in konfirmues).

Dokumentet që duhet të ngarkohen dhe dërgohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dërgimit të tyre: Gjatë aplikimit për pozitën në fjalë kandidatët duhet të kenë kujdes hapat e aplikimit:

- Aplikimi bëhet vetëm përmes adresës (postës) elektronike (email) punesimi@kostt.com
Në email për aplikim duhet të bashkëngjiten (ngarkohen) dokumentet si në vijim:
 - Aplikacionin-CV-në (**ver. 4.0**) të shkarkuar nga web faja zyrtare e KOSTT Sh. A.: www.kostt.com
 - Dëshmia për kualifikimin profesional: Diploma e shkollimit e skanuar në formatin pdf dhe e bashkangjitur në email (nëse diploma është fituar jashtë vendit duhet bashkangjitur vërtetimin e nostrifikimit të diplomës apo aktin që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së punës).
 - Dëshmia për përvojën profesionale: Vërtetim pune (referencë) nga punëdhënësit tuaj të mëparshëm apo aktual me të cilën vërtetohet përvoja juaj për profesionin që keni. Në vërtetim (referencë) duhet të jetë data e fillimit dhe mbarimit të punësimit apo angazhimit tuaj tek punëdhënësi juaj.
 - Dëshmi tjera të dokumenteve sipas kërkesave dhe kritereve të konkursit të brendshëm.

Vërejtje: Gjatë aplikimit aplikantët/kandidatët duhet të kenë gjithashtu kujdes, si në vijim:

Nëse nuk e deklaroni që anëtar i familjes suaj është në marrëdhënie pune me KOSTT, në cilëndo fazë të zhvillimit të vlerësimit të kandidatit që vërtetohet, aplikacionet-CV-të tuaja do të refuzohen. Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa ato të mangëta ose ato që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 10 nga 10</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët, të cilët i plotësojnë kërkesat/kriteret e konkursit të shpallur në tabelën e shpalljeve në KOSTT.

Dokumentacioni shtesë të dërguara nga kandidati pas përfundimit të afatit të aplikimit nuk mund të kërkohej dhe as të pranohet.

Kalendari i përafërt: Pas përfundimit të afatit të aplikimit, brenda 20 dite testimi me shkrim, brenda 15 dite intervista, brenda 5 dite njoftimi final, si dhe brenda 15 dite lidhje e marrëdhënies së punës me kandidatin e suksesshëm.

Kalendari i përafërt do të aplikohet në rast se nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë të rrjedhës së procesit të konkursit sipas UA nr. 01/2024, plotësim ndryshimi i UD 03/2024 dhe në bazë të akteve të brendshme Manualit të punëtorëve dhe Politikës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në webfaqen e KOSTT, nga data **15.01.2026 deri më 29.01.2026 ora 24:00**.